



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SKËNDERAJT PËR VITIN 2022

Prishtinë, qershor 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Skënderajt për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Skënderajt (SK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skënderajt, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Skënderajt kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Kryerja dhe pranimi i punëve dhe faturave para së të bëhet zotimi i mjeteve financiare.
- B1 Menaxhimi i pasurive jo financiare mbi 1,000€ në pesë (5) raste ishte përcaktuar jetëgjatësia jo e duhur e tyre duke ndikuar në saktësinë e zhvlerësimit dhe vlerës neto të tyre, po ashtu pasuritë nën 1,000€ ishin të mbivlerësuara si rezultat i mos zhvlerësimit të tyre gjatë vitit 2022 dhe pjesërisht për disa muaj për disa pasuri edhe gjatë vitit 2021.
- C1 Komuna gjatë vitit 2022 kishte të angazhuar shtatë (7) punonjës me marrëveshje për shërbime të veçanta pa zhvilluar procedura të prokurimit.
- B2 Gjatë trajtimit të detyrimeve të papaguara kemi vërejtur se pesë (5) fatura nuk ishin paguar brenda afatit 30 ditor, vonesat në pagesa ishin nga 39 ditë deri në 254 ditë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Skënderajt.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Skënderajt është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Skënderajt në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Skënderajt me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Skënderajt.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Fushat për përmirësim janë si: kontrollet e brendshme në procesin e hartimit të PVF-ve, mangësi në menaxhimin e shpenzimeve, angazhimi i të punësuarve përmes kontratave për shërbime të veçanta, menaxhimi i projekteve kapitale, menaxhimi i pasurive jo financiare, llogarive të arkëtushme detyrimeve dhe mangësitë në sistemin e NJAB-së. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime, prej tyre një (1) është rekomandim i ri, pesë (5) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Pranimi i faturës para zotimit të mjeteve financiare

Gjetja

Sipas rregullës Financiare nr. 01/2013/MF - shpenzimi i parasë publike, neni 22, hapat për procedim të pagesave janë: kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhër blerja, raporti i pranimit të mallit apo shërbimit, pastaj behet pranimi i faturës, tutje certifikohet/ekzekutohet pagesa në fjalë.

Nga testimi i pagesave të punëve të kryera të projekteve kapitale, kemi hasur në dy (2) raste të pagesave që janë realizuar pa u zbatuar procedurat e duhura. Pra janë kryer dhe pranuar punët dhe faturat para së të behet zotimi i mjeteve.

Rastet kishin të bënin për:

- Trotuaret dhe ndriçimi Lled në BL Likoc, Klinë e Epërme, Runik, Turiqec (situacioni III) në vlerë 87,041€; dhe

- Riparimin dhe mirëmbajtja e rrugëve dhe lumenjve në Bashkësitë Lokale: Kline e Epërme, Prekaz, Turiçevc, Polac, Qirez, Runik, Likoc, Rezallë – Komuna Skënderaj, (situacioni i V) në vlerë 99,978€.

Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e mos efektivitetit të kontrolleve të brendshme gjatë procedimit të lëndëve për pagesë nga zyrtarët financiarë.

Ndikimi

Përveç mos pajtueshmërisë me rregulloren financiare, kjo ndikon në edhe në mundësinë e vonesave të pagesave.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të siguroj se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë se ngjarjeve dhe në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mbivlerësimi/nënvlerësimi i pasurisë si pasojë e zhvlerësimit të gabuar

Gjetja

Rregullore MF - nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton procedurat standarde për dokumentimin, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo-financiare, mbajtjen e saktë të të dhënave mbi pasurinë jo financiare përmes mirëmbajtjes sistematike të regjistrit të pasurive jo financiare kapitale. Po ashtu sipas neni 24 paragrafi 2. Paraqitja në pasqyrat vjetore financiare duhet të bëhet nga E - pasuria për pasuritë me vlerë nën 1,000 € dhe afat të përdorimit mbi një vit.

Çështjet të cilat kemi identifikuar gjatë auditimit lidhur me menaxhimin në fushën e pasurive jo financiare mbi 1,000€ janë:

- Pajisja e regjistruar në regjistrin e pasurisë në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK) në vitin 2015 me vlerë 29,800€ me emërtimin “Agregat gnt 275” ishte regjistruar me

jetëgjatësi të përdorimit 20 vite dhe do të duhej të ishte me 10 vite. Kjo e bënë që zhvlerësimi për pasurinë të jetë mbivlerësuar për vlerën 10,430€;

- Toka e regjistruar në regjistrin e pasurisë në SIMFK në vitin 2009 me në vlerë 7,004€ me emërtimin “Toka shf-k.drenices-abri p-sip.0.35.02ha”, me jetëgjatësi të përdorimit 40 vite, është zhvlerësuar për 13 vite, derisa toka nuk zhvlerësohet. Po ashtu, pasuria e regjistruar në vitin 2009 - “Toka shf-sh.g-radishevë sip.12.29m²”, në vlerë 3,858€ me jetëgjatësi të përdorimit 40 vite, është zhvlerësuar për 13 vite;
- Deri më tani, zhvlerësimi i akumuluar në këto raste për tokën është prej 2,408€ dhe 1,310€ të cilat njëkohësisht kanë ndikuar në nënvlerësimin e pasurisë;
- Shkolla e regjistruar në regjistrin e pasurisë në SIMFK në vitin 2015 me vlerë 204,997€, me emërtimin “Ndërtimi sh.m.gj. Hamzë Jashari -Skënderaj”, ishte regjistruar si investim në vijim. Edhe pse objekti shkollor është në përdorim nga shtatori 2021, në regjistrat e pasurisë, kjo vazhdon të mbetet si investim në vijim duke mos i kalkuluar zhvlerësimin për këtë periudhë. Kjo ka ndikuar në mbivlerësimin e pasurisë për vlerën 6,833€;
- Pajisja e regjistruar në regjistrin e pasurisë në SIMFK me emërtimin “Pompe uji në shkollën fillore në Likovcë”, e blerë në vlerë 2,600€ në vitin 2015, ishte regjistruar me jetëgjatësi të përdorimit 25 vite, ndërsa do të duhej të ishte me gjashtë (6) vite. Si rrjedhojë, kjo ka ndikuar në mbivlerësimin e pasurisë për vlerën 1,785€.

Vlera e pasurive jo financiare nën 1,000€ ishte 195,419€, ndërsa çështjet e identifikuar lidhur me menaxhimin e tyre janë:

- Komuna ka paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e njëjtë të pasurive nën 1,000€ të marra nga sistemi “e-pasuria”, por ky sistem kishte probleme dhe mangësi, ku nuk ishte kalkuluar zhvlerësimi i pasurive gjatë vitit 2022, ndërsa për vitin 2021 vetëm pjesërisht, pra sipas muajve në disa raste po dhe në disa raste jo. Kjo ka ndikuar në një mbivlerësim të vlerës së pasurive nën 1,000€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së mjaftueshme të kontrolleve të brendshme ndaj menaxhimit të pasurive jo financiare, dhe në anën tjetër për shkak të mos funksionimit të sistemit “e-pasuria” në nivelin qendrorë.

Ndikimi

Kjo ndikon në prezantimin e pasaktë në vlerat e tyre neto në librat e pasurive dhe rrjedhimisht edhe në pasqyrat financiare vjetore.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive dhe të bëjë një rishikim dhe të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë në regjistrat kontabël, dhe të bëjë një rivlerësim të gjithë listës së pasurive të komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Angazhimi i stafit më marrëveshje për shërbime të veçanta pa procedura të prokurimit

Gjetja

Sipas nenit 84 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik përcakton Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të

prokurimit publik ku, sipas paragrafit 4 të ndryshim plotësimit të rregullave për prokurim të shërbimeve të veçanta (konsulent/kontraktoret individual) këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimi. Marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik.

Komuna gjatë vitit 2022 kishte të angazhuar shtatë (7) punonjës me marrëveshje për shërbime të veçanta pa zhvilluar procedura të prokurimit. Nga testimi i pesë (5) mostrave, rezulton se këto pozita ishin kryesisht për pozita të rregullta të punës si specialist i mjekësisë, pediatër dhe staf shëndetësor. Punonjësit e angazhuar ishin të sapo dal në pension të cilët më herët ishin punëtor shëndetësor në QKMF.

Një dukuri e tillë ka ndodhur për shkak të mungesës së mjekëve të rregullt në QKMF.

Ndikimi

Mbulimi i pozitave të rregullta të punës me marrëveshje për shërbime të veçanta kufizon konkurrencën e lirë, dhe ka ndikim në performancë të dobët të stafit dhe rrit pasigurinë nëse në pozitat e tilla është angazhuar stafi adekuat apo meritör.

Rekomandimi C1

Kryetari, duhet të sigurojë që nevojat e komunës për pozitat të rregullta të adresohen në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve dhe aty ku është e nevojshme angazhimi i stafit me marrëveshje të veçanta, të respektohen kërkesat ligjore në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Vonesa në pagesën e faturave të pranuar

Gjetja

Ligji Nr.03/L-048 për MFPP, nenin 39.1, përcakton që "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore".

Gjatë trajtimit të detyrimeve të papaguara kemi vërejtur se pesë (5) fatura nuk ishin paguar brenda afatit 30 ditor, vonesat e pagesave për këto raste janë nga 39 ditë deri në 254 ditë:

Fatura e pranuar me 27.10.2022 në vlerë 4,913€, ishte paguar me 22.02.2023;

Fatura e pranuar me 03.11.2022 në vlerë 6,320€, ishte paguar me 07.02.2023;

Fatura e pranuar me 16.12.2022 në vlerë 11,100€, ishte paguar me 23.02.2023;

Fatura e pranuar me 06.05.2022 në vlerë 40,000€, ishte paguar me 14.02.2023; dhe

Fatura e pranuar me 06.05.2022 në vlerë 80,000€, ishte paguar me 21.02.2023.

Shkaku i mospagesës me kohë të detyrimeve ishte mungesa e mjeteve të buxhetuara për kodin ekonomik përkatës.

Ndikimi

Detyrimet e bartura rrisin rrezikun në realizimin e projekteve dhe në arritjen e objektivave të komunës. Si rezultat i nevojës për t'i paguar obligimet e viteve paraprake, njëherit kjo ndikon edhe në kosto shtesë në rast të padive nga furnitorët.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë një planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve si dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të vonesave për pagesat e faturave apo të shmangies së padive eventuale nga operatorët ekonomik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Të arkëtueshmet

Skënderaj në PFV e vitit 2022 ka shpalosur Llogari të Arkëtueshme (LI/A) në vlerë prej 1,562,158€. Kjo vlerë përbëhet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë, taksa në biznes, shfrytëzimi i pronës publike (renta dhe qiraja) si dhe lejet ndërtimore.

Çështja B3 - Mangesi në menaxhimin e Llogarive të Arkëtueshme

Gjetja Arkëtimi i të hyrave bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Pjesa më e madhe e LL/A-ve i takon tatimit në pronë në vlerë 1,170,307€ rreth 75%, taksa komunale në biznes në vlerë 246,968€ rreth 16%, dhe shfrytëzimi i pronës publike (renta dhe qiraja) në vlerë 144,883€ rreth 9%. Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja e tyre vit pas viti. Në krahasim me vitin paraprak rritja ishte 193,287€ respektivisht rreth 14%.

Rritja e LI/A ishte për shkak të kontrolleve të brendshme jo efikase në menaxhimin dhe angazhimin për realizimin e arkëtimit të tatimeve dhe taksave komunale, por edhe gjendja ekonomiko sociale e qytetarëve.

Ndikimi Mos arkëtimi në kohë i të hyrave ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal dhe rrjedhimisht ndikon në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetjake.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme duke hartuar dhe aplikuar plane dhe procedura të qarta, apo ndërmarrjen e veprimeve ligjore për arkëtimin e LI/A.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) kishte vetëm një Auditor të brendshëm të transferuar përkohësisht (6 muaj) prej 01.09.2022 deri më 28.02.2023 nga Ministria e financave, Punës dhe Transfereve. Aktualisht komuna ishte në process të përzgjedhjes të drejtorit të NJAB. Përveç planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe planin vjetor të punës ku ishin përfshirë katër (4) auditime. Janë përfunduar nga një kompani private e auditimit që e ka angazhuar komuna. Auditimet ishin fokusuar në fushën e prokurimit, pasurive, automjeteve si dhe në fushën e gjeodezisë. Aktualisht Komiteti i auditimit ishte jo funksional.

Çështja B4 - Mos kompletimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Gjetja Rregullore QRK – nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, neni 5 i saj përcakton, Kriteret për themelimin e Njesisë së auditimit të brendshëm (NjAB) dhe për zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm, subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion € të ketë së paku tre (3) auditorë të brendshëm.

NjAB në Komunën Skënderajt përbëhet vetëm nga auditor i brendshëm, i cili është angazhuar përmes transferit të përkohshëm (6 muaj) prej 01.09.2022 deri më 28.02.2023 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Komuna kishte bërë përpjekje për të rekrutuar Udhëheqësin e NjAB-së dhe Auditorin e Brendshëm, por procesi kishte rezultuar i pa suksesshëm. Në mungesë të auditorit të brendshëm, Komuna pasi kishte marrë pëlqimin nga Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm, kishte angazhuar një kompani private për të kryer shërbimin e auditimit të brendshëm.

Shkaqet e mos plotësimit të NjAB-së janë në mungesë të kandidatëve të kualifikuar sipas kërkesave të konkursit për këtë pozitë.

Ndikimi Mos kompletimi i NjAB me staf të mjaftueshëm, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve me kohë për parandalimin e gabimeve të mundshme dhe forcimin e kontrolleve të brendshme.

Rekomandimi B4 Kryetari, duhet të sigurojë që pozitën e zbrazëta në NjAB të plotësohen sa me herët të jetë e mundshme, që do të ndikonin në funksionimin dhe forcimin e kontrolleve të brendshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Komiteti i auditimit jo funksional

Gjetja UA MF-Nr. 01/ 2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik, neni 4 themelimi i komitetit të auditimit, paragrafi 1. Çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësine e auditimit të brendshëm në nivel të organit kryesor sipas legjislacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit.

Komiteti i auditimit nuk kishte mbajtur takimet e rregullta në secilin tremujor,

por kishte mbajtur katër takimet në katëmuorin e fundit të vitit.

Aktualisht Komiteti i Auditimit është jo funksional meqenëse tani ka mbet me vetëm një anëtar.

Kjo kishte ndodhur për shkak se dy anëtar të komitetit të auditimit ishin tërhequr meqenëse ishin punësuar si zyrtar të rregullt, dhe komuna nuk ka plotësuar komitetin me anëtar tjerë.

Ndikimi

Mos funksionimi i komitetit të auditimit ndikon që auditimi i brendshëm të mos i japë rezultatet e punës së vet në përforcimin e kontrolleve të brendshme në organizatë buxhetore.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë që komiteti i auditimit të jetë funksional, që t'i ndihmon në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike, me qëllim që të arrihen objektivat e synuara të organizatës, duke ofruar këshilla dhe rekomandime që kanë të bëjnë me qeverisjen, menaxhimin e rrezikut dhe proceset e kontrollit të brendshëm.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	14,528,789	15,041,267	14,195,206	14,057,504	14,158,325
Grante Qeveritare – Buxheti	13,139,509	13,147,095	12,543,990	12,485,548	12,789,981
Financimi përmes huamarrjes	0	129,597	129,597	63,496	136,390
Të bartura nga viti i kaluar	0	351,340	309,371	313,788	561,316
Të hyrat vetanake	1,389,280	1,389,280	1,197,791	1,063,816	643,748
Donacionet vendore	0	7,770	0	1,242	0
Donacionet e jashtme	0	16,185	14,456	129,615	26,890

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 512,478€. Kjo rritje është rezultat i ndryshimit të bëra nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti paraprak dhe nga efekti i vendimit të qeverisë për shtesat në pagë për punonjësit shëndetësor të sektorit publik.

Në vitin 2022 Skënderaj ka shpenzuar rreth 94% të buxhetit final ose 14,195,206€, me një ulje rreth 1% në krahasim me vitin 2021. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	14,528,789	15,041,267	14,195,206	14,057,504	14,158,325
Pagat dhe mëditjet	8,350,001	8,487,184	8,127,199	8,301,053	8,117,827
Mallrat dhe shërbimet	1,700,000	1,827,361	1,773,318	1,499,467	2,398,184
Komunalitë	200,000	200,000	198,310	201,916	183,022
Subvencionet dhe transferet	730,000	805,000	803,249	735,777	573,595
Investimet Kapitale	3,408,788	3,721,722	3,293,129	3,319,291	2,885,696
Rezervat	140,000	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Kategoria e pagave në buxhetin final kishte një rritje për 137,183€ krahasuar me buxhetin fillestar dhe një realizim prej 96%.
- Kategoria mallra dhe shërbime në fund të vitit kishte rritje të buxhetit për 127,361€ dhe ishte realizuar rreth 97%.
- Kategoria e komunalive në fund të vitit kishte nuk kishte ndonjë ndryshim të buxhetit dhe ishte realizuar rreth 99%.
- Kategoria subvencioneve dhe transfereve, në fund të vitit kishte rritje të buxhetit për 75,000€ dhe ishte realizuar rreth 100%.
- Kategoria investime kapitale në fund të vitit, kishte rritje të buxhetit për 312,934€, kjo rritje ishte për 140,000€ që ishin transferuar nga rezervat që ishin për investime kapitale, nga të hyrat vetjake për 110,263€, nga donacionet për 14,456€, dhe 48,215€ të tjera dhe në fund të vitit ishte realizuar në vlerë 3,293,129€ apo rreth 88%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara në 2022 ishin në vlerë 1,444,554€. Ato kanë të bëjnë me 336,698€ të hyrat tatimore dhe 1,107,856€ për të hyrat jo tatimore.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	1,389,280	1,389,280	1,444,554	1,261,294	660,933

Të hyrat tatimore	355,987	355,987	336,698	282,731	189,768
Të hyrat jo tatimore	1,033,293	1,033,293	1,107,856	978,563	470,340
Të hyrat tjera	0	0			826

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 për Skënderaj ka rezultuar në 11 rekomandime kryesore. Komuna e kishte diskutuar këtë raport në asamblenë komunale dhe kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, pesë (5) rekomandime janë zbatuar pesë (5) ende nuk ka filluar zbatimin dhe një (1) pjesërisht i zbatuar, siç është paraqitur në Grafikonin 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari, duhet të sigurojë se që nevojat e komunës për pozitat të rregullta të adresohen në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve dhe aty ku është e nevojshme angazhimi i stafit me marrveshje të veçanta, të respektohen kërkesat ligjore në fuqi.	Edhe këtë vit në sektorin e shëndetësisë ka staf të angazhuar me MSHV pa procedura të prokurimit.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë një planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve si dhe iniciimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të pagesës së detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik. Po ashtu raportet mujore të obligimeve të rishikohen për qëllimin e plotësisë para se të dorëzohen në Thesar.	Edhe këtë vit ka vonesa në pagesën e faturave.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Pasqyrat	Kryetari duhet të shtoj kontrollet gjatë	Këtë vit nuk ka	I zbatuar

	Financiare Vjetore	hartimit të PVF-ve, në mënyrë që PVF-të për vitin 2022 të mos përmbajnë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të nënshkruaj vetem pasi që janë siguruar se PVF-të prezantojnë të dhëna të plota dhe të sakta.	çështje të tilla.	
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e sistemit të kontrolleve të brendshme në këtë fushë, procedimi dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve dhe kategorive ekonomike adekuate në përputhje me planin kontabël të miratuar nga Thesari.	Ketë vit nuk janë identifikuar keq klasifikime të shpenzimeve.	I zbatuar
5.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se me qëllim të realizimit me kohë të projekteve kapitale, paraprakisht të jenë siguruar fondet për realizimin e projektit dhe ka ndermarrë të gjitha masat për evitimin e pengesave në zbatim të kontratës.	Ketë vit nuk kemi identifikuar çështje të tillë.	I zbatuar
6.	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive të kryhet në të gjithë sektorët dhe komisionet duhet të bëjnë krahasimin e rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i verifikuar të gjitha pasuritë sipas gjendjes me vlerë, në përdorim dhe jashtë përdorimit.	Ketë vitit është kryer për të gjitha pasuritë procesi i inventarizimit të pasurive jo financiare.	I zbatuar
7.	Pasuritë	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive dhe të bëjë një rishikim dhe të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë në regjistrat kontabël, dhe të bëjë një rivlerësim të të gjithë listës së pasurive të komunës.	Ketë vit ka një përmirësim në disa raste, por ende ka çështje të ngjashme si në vitin e kaluar.	Nuk ka filluar zbatim
8.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme duke hartuar dhe aplikuar plane dhe procedura të qarta për mënyrën e arkëtimit të tyre.	Edhe gjatë këtij vitit kishte rritje të arkëtueshmeve rreth 14% krahasuar me vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatim
9.	Detyrimet Kontigjente	Kryetari duhet të sigurojë se lista e detyrimeve kontingjente duhet të jetë e bazuar mbi dëshmitë përkatëse dhe të sakta, dhe që përditësohet në periudha të rregullta, në mënyrë që të dëshmojnë vlerën financiare dhe të siguroj pretendimet e tilla që kanë të bëjnë me komunën.	Ketë vit nuk ka çështje të tillë.	I zbatuar
10.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë që pozitat e zbrazëta në NjAB të plotësohen sa me herët të jetë e mundshme, që do të ndikojnë në funksionimin dhe forcimin e kontrolleve të brendshme.	NjAB ende nuk ishte kompletuar me staf sipas kërkesave ligjore.	Nuk ka filluar zbatim
11.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë që komiteti i auditimit të jetë funksional, që t'i ndihmon në përmirësimin e sistemit të kontrollit të	Edhe ketë vit gjendja është e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatim

		brendshëm të financave publike, me qëllim që të arrihen objektivat e synuara të organizatës, duke ofruar këshilla dhe rekomandime që kanë të bëjnë me qeverisjen, menaxhimin e rrezikut dhe proceset e kontrollit të brendshëm.		
--	--	---	--	--


Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Enver Boqolli, Udhëheqës i ekipit



Aurora Morina, Anëtare e ekipit



Agim Sogojeva, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opštine Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Skenderajt, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Fadil Nura


Kryetar i Komunës së Skenderajt
Data: 14.Prill.2023, Skenderaj,

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.